


Tregtia e jashtme e mallrave

Gusht 2017

Tiranë, më 18 Shtator 2017: Në Gusht 2017 eksportet e mallrave arritën vlerën 18 mld lekë, duke u rritur me 12,0 %, në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë dhe duke u ulur me 25,6 %, në krahasim me Korrik 2017. Importet e mallrave në Gusht 2017 arritën vlerën 49 mld lekë, duke u rritur me 6,0 %, në krahasim me një vit më parë dhe duke u ulur me 10,1%, në krahasim me Korrik 2017. Deficiti tregtar i këtij muaji është 31 mld lekë, duke u rritur me 2,8 %, krahasuar me Gusht 2016 dhe me 2,5 %, në krahasim me Korrik 2017.

Fig. 1 Ndryshimi vjetor në tregtinë e mallrave, Gusht 2013 –Gusht 2017 (%)




Në tetë muajt e parë eksportet e mallrave arritën vlerën 177 mld lekë, duke u rritur me 12,8 %, krahasuar me një vit më parë dhe importet e mallrave arritën vlerën 400 mld lekë, duke u rritur me 6,3 %, krahasuar me një vit më parë. Deficiti tregtar arriti vlerën 223 mld lekë, duke u rritur me 1,6 %, krahasuar me 2016.

Ndikimi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të eksporteve:

Rritja vjetore e eksporteve prej 12,0 %, këtë muaj është ndikuar kryesisht nga grupet: “Materiale ndërtimi dhe metale” me +6,1 pikë përqindje, “Tekstile dhe këpucë” me +3,3 pikë përqindje, “Ushqime, pije, duhan” me +2,3 pikë përqindje. Grupi që ka ndikuar negativisht në ndryshimin vjetor të eksporteve, është: “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me -3,1 pikë përqindje.

Fig.2 Ndikimi i grupeve në ndryshimin vjetor të eksporteve, Gusht 2017




Eksportet, gjatë këtij tetëmujori janë rritur me 12,8 %, krahasuar me një vit më parë. Grupet që kanë ndikuar pozitivisht në rritjen vjetore të eksporteve, janë: “Materiale ndërtimi dhe metale” me +5,1 pikë përqindje, “Tekstile dhe këpucë” me +3,9 pikë përqindje, “Ushqim, pije, duhan” me +1,7 pikë përqindje. Në ndryshimin vjetor të eksporteve, nuk ka ndikuar negativisht asnjë grup.

Ndikimi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të importeve:

Rritja vjetore e importeve prej 6,0 %, këtë muaj është ndikuar kryesisht nga grupet: “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me +5,3 pikë përqindje, “Ushqim, pije, duhan” me +1,8 me pikë përqindje, “Tekstile dhe këpucë” me +1,2 pikë përqindje. Në ndryshimin vjetor të importeve ka ndikuar negativisht grupi: “Makineri, paisje, pjesë këmbimi” me -2,5 pikë përqindje, “Prodhime druri dhe letre” me -0,5 pikë përqindje, “Produkte kimike dhe plastike” me -0,2 pikë përqindje.

Fig.3 Ndikimii grupeve në ndryshimin vjetor të importeve, Gusht 2017



Importet, gjatë këtij tetëmujori, janë rritur me 6,3 %, krahasuar me një vit më parë. Grupet që kanë ndikuar pozitivisht në rritjen vjetore të importeve, janë: “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me +1,4 pikë përqindje “Produkte kimike dhe plastike” me +1,2 pikë përqindje, “Tekstile dhe këpucë” me +1,2 pikë përqindje. Në ndryshimin vjetor të eksporteve, nuk ka ndikuar negativisht asnjë grup.

Ecuria e tregtisë së mallrave sipas vendeve partnere


Në muajin Gusht 2017, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të eksporteve, në krahasim me Gusht 2016 janë: Italia me (14,4 %), Kosova me (30,7 %) dhe Maqedonia me (54,3 %). Ndërsa vendet me të cilat eksportet kanë pasur uljen më të madhe janë: Spanja me (-0,2%), Greqia me (-6,4 %) dhe Mali i Zi me (-2,6 %).

Gjatë këtij tetëmujori, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të eksporteve, në krahasim me një vit më parë, janë: Italia me (8,4 %), Kosova me (28,8 %) dhe Spanja me (117,6 %). Ndërsa vendet me të cilat eksportet kanë pasur uljen më të madhe, janë: Bullgaria me (-1,3 %), Zvicra me (-50,6 %) dhe Kroacia me (-28,3 %).

Në muajin Gusht 2017, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të importeve, në krahasim me Gusht 2016 janë: Greqia me (19,6 %), Kina me (13,9 %) dhe Gjermania me (7,5 %). Ndërsa vendet me të cilat importet kanë pasur uljen më të madhe janë: Italia me (-5,0 %), Turqia me (-8,0 %) dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës me (-44,8 %).

Gjatë këtij tetëmujori, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të importeve, në krahasim me një vit më parë, janë: Italia me (4,0 %), Greqia me (13,3 %) dhe Turqia me (13,1 %). Ndërsa vendet me të cilat importet kanë pasur uljen më të madhe, janë: Gjermania me (-4,3 %), Kina me (-6,4 %) dhe Rusia me (-4,4 %).

Fig.4 Tregtia e jashtme e mallrave sipas disa vendeve të BE-së, Gusht 2017



Shkëmbimet tregtare me vendet e BE zënë 58,9 %, të gjithë tregtisë. Në Gusht 2017, eksportet drejt vendeve të BE-së zënë 70,1 % të eksporteve gjithsej dhe importet nga vendet e BE-së zënë 54,7 % të importeve gjithsej. Partnerët kryesorë tregtarë janë: Italia (27,0 %), Greqia (7,8 %), Kina (7,5 %) dhe Gjermania (7,0 %).

Shkëmbimet tregtare, për tetëmujorin 2017, me vendet e BE zënë 66,0 % të gjithë tregtisë. Në periudhën Janar – Gusht 2017, eksportet drejt vendeve të BE-së zënë 76,6% të eksporteve gjithsej dhe importet nga vendet e BE-së zënë 63,1 % të importeve gjithsej. Partnerët kryesorë tregtarë janë: Italia (36,3 %), Greqia (7,2 %), Gjermania (7,1 %) dhe Kina (6,4 %).

Tab. 1 Qarkullimi i mallrave (miliardë lekë)

Vitet	Muajt	Eksporte	NdryshimiVjetor	Importe	NdryshimiVjetor	BilanciTregtar	% e mbulimit
2000		37	-23,5	157	-1,5	-120	23,6
2001		44	19,1	190	21,0	-146	23,2
2002		47	7,7	210	10,6	-163	22,6
2003		54	14,7	226	7,4	-171	24,1
2004		62	14,0	236	4,5	-174	26,3
2005		66	6,0	262	11,1	-196	25,1
2006		77	17,6	299	14,1	-222	25,9
2007		97	25,5	376	25,8	-279	25,8
2008		113	15,8	440	16,9	-327	25,6
2009		105	-7,2	429	-2,5	-324	24,4
2010		162	54,6	478	11,4	-316	33,8
2011		197	21,9	544	13,9	-347	36,2
2012		213	8,2	528	-2,9	-315	40,3
2013		246	15,7	517	-2,1	-271	47,6
2014		256	3,8	552	6,7	-297	46,3
2015		243	-4,9	545	-1,4	-301	44,7
2016		243	0,1	579	6,4	-336	42,0
2015	01 - 15	18	-0,6	35	0,9	-17	50,4
	02 - 15	18	-9,4	39	-0,8	-20	47,3
	03 - 15	22	4,1	44	4,6	-22	49,9
	04 - 15	21	-8,5	44	-1,4	-23	47,6
	05 - 15	24	-4,8	44	-8,0	-20	54,3
	06 - 15	24	7,4	49	-0,8	-25	49,3
	07 - 15	23	-1,6	52	11,1	-30	43,0
	08 - 15	15	-17,3	40	-10,0	-25	38,3
	Janar – Gusht 2015	165	-3,6	348	-0,6	-183	47,5
2016	01 - 16	16	-7,8	35	-1,0	-18	47,0
	02 - 16	18	-4,4	42	7,6	-24	42,0
	03 - 16	19	-12,7	47	5,6	-28	41,2
	04 - 16	21	1,7	52	19,0	-31	40,7
	05 - 16	21	-14,8	52	16,7	-31	39,6
	06 - 16	23	-6,4	52	6,2	-29	43,5
	07 - 16	23	-0,2	50	-4,5	-28	44,9
	08 - 16	16	6,9	47	15,9	-30	35,3
	Janar – Gusht 2016	157	-5,3	376	8,0	-219	41,6
2017	01 - 17	19	15,5	35	0,9	-16	53,8
	02 - 17	20	14,2	44	5,1	-24	45,7
	03 - 17	24	22,0	54	14,9	-30	43,8
	04 - 17	24	13,7	50	-3,9	-26	48,1
	05 - 17	24	18,2	56	7,4	-31	43,6
	06 - 17	23	-0,1	57	9,2	-34	39,7
	07 - 17	25	9,9	55	9,6	-30	45,1
	08 - 17	18	12,0	49	6,0	-31	37,3
	Janar – Gusht 2017	177	12,8	400	6,3	-223	44,2

Tab. 2 Tregtia e jashtme e mallrave sipas vendeve partnere (milionë lekë)

	Eksporte				Importe			
	Gusht-16	Gusht-17	Jan.- Gsh. 2016	Jan.-Gsh. 2017	Gusht-16	Gusht -17	Jan.- Gsh. 2016	Jan.-Gsh. 2017
Vendet e BE-së	12.147	12.906	124.271	135.316	27.413	26.955	234.558	245.027
Austri	86	134	741	1.067	1.421	506	4.758	4.080
Mbretëri e Bashkuar	49	74	336	311	266	373	2.693	3.438
Gjermani	639	780	5.270	7.235	3.687	3.962	34.945	33.443
Greqi	748	700	7.313	7.698	3.847	4.599	29.843	33.798
Itali	6.939	7.939	87.104	94.402	10.914	10.366	110.663	115.037
Spanjë	1.442	1.439	4.362	9.492	1.025	1.304	8.222	9.253
Kroaci	35	63	729	523	273	331	2.736	2.973
Tëtjër të BE-së	2.209	1.776	18.416	14.587	5.980	5.513	40.698	43.004
Kinë	583	724	3.722	5.610	3.845	4.378	33.172	31.037
Kosovë	1.504	1.965	10.745	13.835	482	799	3.605	5.328
Maqedonia	658	1.015	3.978	5.672	681	661	4.762	5.401
Rusi	5	29	52	84	1.069	2.153	7.625	7.291
SHBA	199	446	1.078	1.966	1.223	675	7.478	6.001
Turqi	190	195	1.095	1.469	4.015	3.692	28.873	32.661
Ukrainë	28	40	145	337	330	138	2.393	2.247
Zvicër	241	27	1.684	831	607	1.452	4.767	6.126
Tëtjër	877	1.058	9.765	11.512	6.851	8.417	48.791	58.582
Gjithsej	16.431	18.407	156.534	176.632	46.515	49.321	376.024	399.701

Tab. 3 Tregtia e jashtme sipas grup mallrave (milionë lekë)

Grup-mallrat	Eksporte				Importe			
	Gusht-16	Gusht -17	Jan.- Gsh. 2016	Jan.-Gsh. 2017	Gusht-16	Gusht -17	Jan.- Gsh. 2016	Jan.-Gsh. 2017
Gjithsej	16.431	18.407	156.534	176.632	46.515	49.321	376.024	399.701
Ushqime, pije, duhan	1.644	2.028	15.454	18.193	9.379	10.216	66.605	70.581
Minerale, lëndë djegëse, en.el.	3.829	3.327	28.845	29.309	4.898	7.364	31.900	37.190
Produkte kimike dhe plastike	355	466	2.824	3.139	6.542	6.442	52.923	57.461
Lëkurë dhe artikujt prej tyre	59	130	1.781	1.961	920	918	11.540	12.428
Prodhime druri dhe letre	491	508	4.906	4.966	2.057	1.830	15.097	15.173
Tekstile dhe këpucë	6.619	7.169	70.889	76.975	4.294	4.832	50.590	55.113
Materiale ndërtimi dhe metale	2.307	3.318	20.001	28.018	5.382	5.630	49.897	51.272
Makineri, pajisj edhe pjesë këmbimi	642	887	7.203	9.190	11.527	10.368	83.915	84.704
Të tjera	485	573	4.628	4.882	1.514	1.720	13.557	15.779

Tab. 4 Eksportet sipas grup mallrave dhe partnerëve kryesorë, (Janar – Gusht 2016, Janar –Gusht 2017)

(milionë lekë)

	Itali		Kosovë		Spanjë		Greqi	
	2016	2017	2016	2017	2016	2017	2016	2017
Gjithsej	87.104	94.402	10.745	13.835	4.362	9.492	7.313	7.698
Ushqim, pijeduhan	4.402	4.481	1.772	1.962	537	528	1.547	1.217
Minerale, lëndë djegëse, ener. elek.	5.359	5.527	2.176	3.649	1.550	7.153	305	211
Produkte kimike dhe plastike	863	852	857	833	0	13	261	370
Lëkurë dhe artikuj prej lëkure	1.617	1.486	0	4	3	42	34	39
Prodhime druri dhe letre	3.616	3.477	208	264	4	3	587	681
Tekstile dhe këpucë	56.469	60.437	52	89	1.837	1.526	3.119	3.516
Materiale ndërtimi dhe metale	8.062	10.527	4.404	5.787	395	220	1.160	1.031
Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi	4.789	5.426	430	444	23	1	40	375
Të tjera	1.927	2.190	846	804	12	5	259	257

Tab. 5 Importet sipas grup mallrave dhe partnerëve kryesorë, (Janar - Gusht 2016, Janar - Gusht 2017)

(milionë lekë)

	Itali		Greqi		Gjermani		Turqi	
	2016	2017	2016	2017	2016	2017	2016	2017
Gjithsej	110.663	115.037	29.843	33.798	34.945	33.443	28.873	32.661
Ushqim, pije duhan	11.463	12.086	9.687	9.290	2.917	2.758	3.647	3.907
Minerale, lëndë djegëse, ener. elek.	13.425	10.073	3.744	5.546	337	407	654	1.259
Produkte kimike dhe plastike	10.914	12.152	5.057	5.305	4.297	5.157	4.229	4.890
Lëkurë dhe artikuj prej lëkure	9.008	9.602	100	48	3	7	268	236
Prodhime druri dhe letre	4.090	4.134	1.802	2.134	574	539	2.061	2.234
Tekstile dhe këpucë	25.934	27.830	2.328	2.539	1.693	1.654	9.001	9.885
Materiale ndërtimi dhe metale	10.778	12.965	4.335	6.139	9.541	4.853	3.581	3.942
Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi	21.288	22.088	1.782	1.640	14.556	16.860	4.156	4.754
Të tjera	3.761	4.107	1.008	1.158	1.027	1.209	1.277	1.554

Përkufizime

Eksportet janë në përgjithësi mallra të destinuara tek një vend i tretë, të vendosura nën regjimin doganor, në përpunimin pasiv, ose të rieksportuar pas përpunimit aktiv.

Vlera F.O.B: Është vlera e mallrave të eksportuara deri në kufirin e vendit eksportues, pra përfshin koston e mallrave të eksportuara dhe shpenzimet deri në kufi të vendit eksportues.

Importet janë në përgjithësi mallra që vinë nga një vend i tretë, të vendosura direkt në qarkullim të lirë ose që qëndrojnë në magazinat e ruajtjes nën procedurat doganore të lejimit për qarkullim të lirë, për përpunim aktiv ose për përpunim nën kontrollin doganor.

Vlera C.I.F: Është vlera e mallrave të importuara dërguar deri në kufirin e vendit importues, pra përfshin koston e mallit, edhe shpenzimet e transportit dhe sigurimit deri në kufirin e vendit që importon mallrat.

Nomenklatura e Kombinuar (NK) është një nomenklaturë mallrash e përdorur për statistikat e tregtisë ndërkombëtare të mallrave dhe për tarifatat doganore.

<http://www.instat.gov.al/al/metodologji/klasifikime-nomenklatura.aspx>;

Vendet anëtare të Bashkimit Evropian: Belgjikë, Gjermani, Francë, Itali, Luksemburg, Holandë, Mbretëria e Bashkuar, Danimarkë, Irlandë, Greqi, Spanjë, Portugali, Austri, Finlandë, Suedi, Qipro, Çeki, Estoni, Hungari, Letoni, Lituani, Maltë, Poloni, Sllovaki, Slloveni, Bullgari, Rumani, Kroaci.

Shpjegimi i simboleve

0 vlerë më e vogël se gjysma e njësisë matëse

- pa vlerë

÷ deri